



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201800030/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake për njoftimin paraprak të qytetarëve në rastet e prishjes së objekteve të ndryshme nga IMT dhe IKMT, të organizimit të tubimeve, bllokimit të rrugëve për arsye të rikostruksionit të tyre apo aktiviteteve social-kulturore, etj.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**  
**Tiranë**

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË**  
**Tiranë**

**POLICISË BASHKIAKE**  
**Tiranë**

Në vijim të bashkëpunimit tonë të vazhdueshëm për rritjen e performancës së strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake Tiranë, për zbatimin dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve po ju bëjmë prezent shqetësimin e mëposhtëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me nismën e vet konform dispozitave të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, rastin e bërë publik në disa media vizive në datën 12.11.2019, situatë në të cilën për shkak të aksionit të IKMT-së në Unazën e Re Tiranë, strukturat e policisë kanë bllokuar rrugët e kalimit pa njoftuar më parë qytetarët. Ky veprim i policisë ka shkaktuar si pasojë shqetësimin e shumë qytetarëve të cilët kanë mbetur të bllokuar në mjetet e

transportit publik, mjetet e tyre private apo e disa të tjerëve që lëviznin në këmbë dhe nuk kanë mundur që të shkonin në punë apo në banesat e tyre<sup>1</sup>.

Sipas mediave, bllokimi i rrugëve nga policia në rastet e prishjeve të objekteve nga IKMT dhe IMT Tiranë në qytetin e Tiranës është rast i përsëritur edhe herë të tjera.

Përveç këtij rasti të bërë publik në media, gjatë veprimtarisë tonë kemi konstatuar disa raste të bllokimit të rrugëve kryesisht në qytetin e Tiranës nga Policia e Shtetit por edhe nga Policia Bashkiake. Bllokimi i rrugëve ka qenë i papritur dhe pa njoftim paraprak për shkak të zhvillimit të tubimeve nga subjekte të ndryshme politike apo grupime qytetarësh, sikurse ka ndodhur shpesh herë në Unazën e Re në afërsi të zonës së “Astirit”, në Rrugën “Ali Demi” në zonën e Shkozës, në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, në Rrugën e “Durrësit” në afërsi të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në rastet e kryerjes së punimeve në rrugë të ndryshme të qytetit të Tiranës etj.

Për rastin e bërë publik në media në datën 12.11.2019, në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Tiranë me shkresën nr. 10045/1 prot., datë 17.12.2019 na vuri në dijeni se:

“Strukturat e DVP Tiranë në bazë të kërkesës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) me nr. 4243/1 prot., datë 06.11.2019, dhe lëndë “Kërkesë për mbështetje”, bazuar në aktet ligjore dhe procedurat standarde të punës kanë mbështetur veprimet e IKMT-së për prishjen e objekteve në Unazë (rrethrotullimi i “Shqiponjës” - Ura e Lanës) në datën 12.11.2019, duke bërë bllokimin vetëm të një pjese të rrugës “Teodor Keko”.

Shërbimet e policisë të DVP Tiranë dhe të Policisë Bashkiake Tiranë që nga momenti i vendosjes ku do të kryhej operacioni për prishjen e banesave kanë orientuar drejtuesit e mjeteve dhe qytetarët që të shmangin segmentin fundor të rrugës “Teodor Keko” dhe të përdorin rrugët dytësore të “Unazës”.

Në “Unazë” nga rrethrotullimi i “Shqiponjës” deri tek mbikalimi i Pallatit me “Shigjeta” çdo ditë nga ora 18:00 - 20:00 për një vit rresht ka pasur trafik rrugor të rënduar dhe bllokim rruge, për shkak të bllokimit të rrugës që bënin çdo ditë banorët e Unazës. Ndërsa policia ka bërë menaxhimin e trafikut rrugor duke drejtuar qytetarët dhe drejtuesit e mjeteve të lëviznin në rrugët dytësore të Unazës”.

Nga përgjigjja e dërguar nga DVP Tiranë të cilën e përshkruam më sipër rezulton se në datën 12.11.2019, për të cilën bën fjalë rasti i bërë publik në media, nga strukturat e DVP Tiranë dhe të Policisë Bashkiake Tiranë nuk është bërë ndonjë njoftim para datës dhe orës së bllokimit të këtij segmenti rrugor nëpërmjet mediave apo ndonjë forme tjetër të ligjshme. Ndërkohë, njoftimi i drejtuesve të mjeteve dhe i qytetarëve për të shmangur segmentin fundor të rrugës “Teodor Keko” është bërë në momentin e vendosjes së këtyre shërbimeve për bllokimin e rrugës, ku do të kryhej operacioni për prishjen e banesave.

Gjithashtu vlerësojmë se informacioni i dhënë nga DVP Tiranë, se shërbimet e policisë kanë orientuar drejtuesit e mjeteve dhe qytetarët që të përdorin rrugët dytësore të Unazës nuk është korrekt, sepse në Rrugën “Teodor Keko” apo siç njihet ndryshe “Unaza e Re” Tiranë nuk ka rrugë dytësore. Mungesa e rrugëve dytësore e bën më të komplikuar shqetësimin e qytetarëve këmbësore dhe veçanërisht të drejtuesve të mjeteve për të lëvizur lirisht për në destinacionin e planifikuar.

---

<sup>1</sup> Mediat kanë bërë publike disa raste që qytetarë të ndryshëm për shkak të bllokimit të rrugëve dhe ngutjes së tyre për të shkuar në punë apo në banesa janë detyruar që të kalojnë përmes lumit të Lanës. Gjithashtu në media u bënë publike edhe disa raste të shqetësimeve të ndryshme të qytetarëve që banonin në afërsi të zonës ku do të bëheshin prishjet e objekteve, si rasti i një nëne të re që kishte lënë fëmijën e mitur vetëm në banesë apo i një zonje që kishte lënë gatimin në sobë, të cilat kishin dalë nga banesat e tyre për të blerë produkte në një market aty pranë, por kur janë kthyer për të shkuar në banesa, rrugët ishin bllokuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake.

Fakti i përmendur në këtë përgjigje, se në “Unazën e Re” nga rrethrotullimi i “Shqiponjës” deri tek mbikalimi i Pallatit me “Shigjeta” çdo ditë nga ora 18:00 - 20:00 për një vit rresht ka pasur trafik rrugor të rënduar dhe bllokim rruge, për shkak të bllokimit të rrugës që bënin çdo ditë banorët e kësaj zone, nuk e justifikon veprimin e kryer nga strukturat e DVP Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë në datën 12.11.2019. Edhe bllokimi i kësaj rruge nga banorët nuk i shërben bashkëjetesës qytetare e konkretisht respektimit të të drejtave të qytetarëve të tjerë drejtues të mjeteve apo këmbësorëve përdorues të saj.

Megjithatë, bllokimi i rrugës nga qytetarët e kësaj zone i referuar prej jush në shpjegimet tuaja, megjithë problemet që mbartte, bëhej në një orar i cili ka qenë i njohur për shumë drejtues mjeteve dhe ata duke e ditur këtë fakt, në orët 18:00 - 20:00 e shmangnin qarkullimin në këtë segment rrugor. Ndërsa në datën 12.11.2019, bllokimi i rrugës është bërë nga strukturat shtetërore dhe jo në orët e mbrëmjes si zakonisht, por në mëngjes. Kjo ka bërë që ata të gjendeshin para të papriturave duke u bllokuar në rrugë.

Avokati i Popullit vlerëson se, rastet e bllokimit të rrugëve nga Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake pa njoftim paraprak të qytetarëve, sjellin si pasojë krijimin e radhëve të gjata të automjeteve që shkon edhe deri në disa kilometra. Kjo situatë shkakton stres dhe irritim të drejtuesve të mjeteve dhe të qytetarëve të ndryshëm që udhëtojnë me mjetet e transportit publik apo privat për shkak të vonesës për të mbërritur në destinacionin e planifikuar për arsye pune, shëndetësore, etj. Duke mos shkuar në kohën apo orën e parashikuar në destinacionin e planifikuar atyre mund t’u shkaktohen pasoja nga më të ndryshme sikurse mund të përmendim: humbjen e avionit për të udhëtuar jashtë vendit; humbjen e mjeteve të transportit për të udhëtuar me linjat ndërqytetase; humbjen e ditës së punës apo cenimin e marrëdhënieve të punës; vënien në rrezik të jetës apo të shëndetit në disa raste kur transportohen persona të sëmurë në institucionet shëndetësore; humbjen e orëve të mësimin për mësuesit, pedagogët, nxënësit e studentët; humbjen apo vonesa në takime/aktivitete të parashikuara në institucione publike ose private etj.

Njoftimi paraprak para bllokimeve të rrugëve i bërë nga strukturat e këtyre organeve nëpërmjet mediave apo ndonjë forme tjetër komunikimi do t’u japë mundësinë drejtuesve të mjeteve të linjave të transportit publik ndër qytetase apo dhe brenda qytetit, si dhe atyre të mjeteve private që të zgjedhin dhe planifikojnë rrugë dhe/ose orare të tjera për të udhëtuar nga njëri destinacion në tjetrin.

Ne çojmë se nuk është në përputhje me frymën e ligjit që, në një shtet të së drejtës organet shtetërore dhe në rastin konkret Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për të përmbushur një detyrë të ligjshme, të cenojnë të drejtat e shtetasve të cilët mund të jenë drejtues mjeteve dhe udhëtarë që lëvizin me mjetet e transportit publik apo privat si dhe këmbësorët për të lëvizur lirisht dhe në një kohë sa më të shpejtë nga një vendndodhje në një tjetër.

Theksojmë se, në bazë të nenit 15/2 të Kushtetutës, *organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.*

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje edhe detyrimin që kanë strukturat e Policisë së Shtetit në bazë të nenit 76/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *për të bashkëpunuar me komunitetin për garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të të drejtave të personave, për rreziqet që mund t’u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale, si dhe në bazë të nenit 77/1, për të informuar publikun dhe median për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

*rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË :**

Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake për njoftimin paraprak të qytetarëve në rastet e bllokimit të rrugëve për arsye të prishjes së objekteve të ndryshme nga IMT dhe IKMT, të organizimit të tubimeve nga subjekte të ndryshme politike ose grupime qytetarësh, të rikonstruksionit të tyre apo të kryerjes së aktiviteteve social-kulturore, etj.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda një afati kohor të përshtatshëm.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**

Konceptoi: S. Nushi